



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 154/2 Prot.

Tiranë, më 19.04.2022

V E N D I M

Nr.55, datë 19.04.2022

Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, të procedurës administrative për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin *** , kryer nga Bashkia Vlorë**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit *****,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është rregjistruar kërkesa me nr.154 prot., datë 09.02.2022, e paraqitur nga nëpunësi ***** , me detyrë “Përgjegjës në Sektorin e Planifikimi të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, në Bashkinë Vlorë, përmes së cilës ngrihen pretendime për pezullim të marrëdhënies në shërbimin civil, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Konkretisht, në përmbajtjen e informacionit të mësipërm parashtrohet se, në përfundim të procedurës së rekrutimit, me aktin nr. 3, datë 28.04.2016, “Për emërimin në detyrë të punonjësve të Bashkisë Vlorë” të njësisë përgjegjëse, konkurrenti ***** është emëruar në pozicionin “Specialist Arkitekt”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, të Bashkisë Vlorë, si nëpunës civil në periudhë prove. Më tej, me aktin nr. 3682 prot., datë 05.05.2017, “Akt deklarimi”, të njësisë përgjegjëse, punonjësi ***** është deklaruar nëpunës civil, në përfundim të periudhës së provës.

Në vijim, me shpalljen e procedurës për plotësimin e pozicionit “Përgjegjës, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, në Bashkinë Vlorë, nëpunësi *****, ka aplikuar për procedurën e ngritjes në detyrë, ku në përfundim të procedurës së konkurrimit për këtë pozicion është shpallur fitues dhe me aktin nr. 1, datë 24.01.2019, (nr. 649 prot., datë 24.01.2019), “Për emërimin në detyrë të punonjësve të Bashkisë Vlorë”, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, pranë Bashkisë Vlorë.

Për shkak të ushtrimit të detyrës në këtë pozicion pune, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 446, datë 09.11.2021, ndaj shtetasit *****, ka dhënë masën e sigurisë “Arrest në burg”, në cilësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim detyre”, kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 e 25, të Kodit Penal. Ky vendim është ndryshuar, me vendimin nr. 450, datë 11.11.2021, “Për verifikimin e masave të sigurimit”, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Konkretisht kjo gjykatë ka vendosur:

*“Zëvendësimin e masës së sigurimit personal shtrenguese të dhënë me vendimin gjyqësor nr. 446 Akti, datë 09.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndaj personit nën hetim *****, i dyshuar për veprën penale të “Shpërdorim detyre” kryer në bashkëpunimin parashikuar nga neni 248 e 25 të Kodit Penal, nga “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal, në atë të “Arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i Kodit Procedurës Penale”.*

Më tej, ky vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është ankimuar nga Prokuroria pranë kësaj gjykate, në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendim nr. 483, datë 01.12.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 450, datë 11.11.2011, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për pjesën që ka zëvendësuar masën e sigurimit “arrest në burg”, të vendosur me vendimin nr. 446, datë 09.11.2021 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ndaj shtetasit *****, të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25, të Kodit Penal, me atë të “arrestit në shtëpi”, duke vendosur:

*“Rrëzimin e kërkesës së prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së shkallës së parë Vlorë, për caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit *****, si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës të kryer në bashkëpunimin, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal”.*

Në këto rrethana, gjendur përballë këtij fakti, Kryetari i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të nenit 54, pika 1, germa c), të Ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 17.02.2016, “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, i ndryshuar; si dhe vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me

nr. 450, datë 11.11.2021, “Për verifikimin e masës së sigurisë”, ka miratuar akt- pezullimi nr. 281, datë 15.11.2011, (15151 prot., datë 15.11.2021), “Për pezullimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të Bashkisë Vlorë”, për punonjësin *****, “Përgjegjës, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, pranë kësaj bashkie, deri në rënien e shkaqeve të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 450, datë 11.11.2021.

Referuar materialit sa më lart, kërkuesi parashtron se, vendimi gjyqësor nr. 450, datë 11.11.2021, është ndryshuar me vendimin nr. 483, datë 01.12.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka rrëzuar kërkesën e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për vendosjen e masës së sigurimit ndaj shtetasit *****, në këto kushte ngre pretendimin se, duke qenë se shkak i pezullimit ka rënë duhet të rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës.

Me qëllim hetimin administrativ të rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kryesisht, ka filluar procesin e verifikimit të ligjshmërisë së këtyre proceseve administrative. Në këtë kuadër, përmes postës elektronike, e-mailit zyrtar datë 17.02.2022, me objekt: “Kërkesë për informacion për verifikimin e ankesës së paraqitur nga nëpunësi *****”, kërkoi nga njësia përgjegjëse, pranë Bashkisë Vlorë, sqarimet për rastin në fjalë si dhe praktikën shkresore të disponuar, duke përfshirë dokumentacionin që materializon veprimet e kryera nga ana e kësaj të fundit.

Në vijim, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Vlorë, përmes e-mailit zyrtar të datës 23.02.2022, me objekt: “Re: Kërkesë për informacion për verifikimin e ankesës së paraqitur nga nëpunësi *****”, ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar.

Në shqyrtim të këtij rasti, instituti i pezullimit në shërbimin civil parashikohet në kreun IX, “Pezullimi nga shërbimi civil”, e konkretisht, në nenin 54, pika 1, germa c), të Ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet se, nëpunësi civil pezullohet nga shërbimi civil në rastet kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë ndaluese pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi;

Ndërsa, në pikën 3, të nenit 54, sanksionohet se, konstatimi i pezullimit bëhet me marrjen dijeni për shkakun e pezullimit, nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi civil është i emëruar.

Më tej, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 124, datë 17.02.2016, “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, i ndryshuar, rregullon procedurat për pezullimin nga shërbimi civil të nëpunësve civilë të të gjitha kategorive dhe lirin nga shërbimi civil për nivelin ekzekutiv, të ulët dhe të mesëm drejtues.

Konstatohet se, në mbështetje të dispozitave ligjore të sipërcituara, në kushtet kur ndaj nëpunësit civil ***** GJykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 450, datë 11.11.2011, ka dhënë masën e sigurisë “Arrest në shtëpi”, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim detyre”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 e 25, të Kodit Penal, me të drejtë Kryetari i Bashkisë ka miratuar akt- pezullimi nr. 281, datë 15.11.2011, (15151 prot., datë 15.11.2021), “Për pezullimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të Bashkisë Vlorë”, për punonjësin ***** “Përgjegjës, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, pranë kësaj bashkie, me afat deri në rënien e shkaqeve të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 450, datë 11.11.2021.

Më tej, me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë nr. 483, datë 01.12.2021, është vendosur ndryshimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 450, datë 11.11.2021, duke rrëzuar kërkesën e prokurorit pranë kësaj Prokurorie për vendosjen e masës së sigurisë ndaj shtetasit ***** duke e hetuar në gjendje të lirë për veprën penale të dyshuar “Shpërdorim detyre”, e kryer në bashkëpunim.

Referuar, nenit 4, “Prezumimi i pafajësisë”, të Kodit të Procedurës Penale, i cili sanksionon se:

“I pandehuri presumohet i pafajshëm, gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.”

i njëjti qëndrim është mbajtur edhe në pikën 1, germa c), të Ligjit 152/2013, i ndryshuar, i cili përcakton se, nëpunësi civil pezullohet nga shërbimi civil në rastet kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë ndaluese, pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi.

Në rastin konkret, ndaj nëpunësit ***** gjykata ka vendosur të heqë masën e sigurisë, duke e hetuar në gjendje të lirë personin e dyshuar, si rrjedhim ndaj këtij personi nuk ka asnjë masë sigurie apo masë ndaluese në fuqi, e cila mund ta pengojë në ushtrimin e rregullt të përditshëm të detyrës.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur, deri në dhënien e një vendimi të formës së prerë nga gjykata, nëpunësi në zbatim të ligjit penal presumohet i pafajshëm dhe çdo dyshim çmohet në favor të tij, nënkuptohet se, arsyeja e pezullimit nuk ekziston më, si rrjedhim institucioni Bashkia Vlorë, duhet të urdhërojë përfundimin e masës së pezullimit e marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësin ***** dhe të vendosë rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës. Gjithashtu, institucioni Bashkia Vlorë dhe njësia përgjegjëse duhet të ketë në vëmendje ndjekjen e procesit gjyqësor me palë të paditur ***** për të qenë në dijeni të vendimit të formës së prerë që do të jepet nga gjykata, në përfundim të gjykimit.

Në rast se, gjykata do ta konsideroj fajtor të paditurin *****, për veprën penale në ngarkim “*Shpërdorim detyre*”, e kryer në bashkëpunimin, institucioni duhet të ndër marrë hapat e mëtejshëm ligjorë, të parashikuar nga legjislacioni për shërbimin civil, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për punonjës.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të Ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; në nenin 4, të Kodit të Procedurës Penale; si dhe në mbështetje të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkojë nga organi publik, Bashkia Vlorë, të konstatojnë përfundimin e shkakut të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të cituar në akt-pezullimin nr. 281, datë 15.11.2011, (15151 prot., datë 15.11.2021), “*Për pezullimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të Bashkisë Vlorë*”, të dhënë për punonjës *****, me detyrë “*Përgjegjës, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*”, duke rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës.
2. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 5 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Vlorë si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha